



Aktivitete në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të GIS Day 2025


Në kuadër të “GIS Day 2025”, ASIG zhvilloi një program aktivitetesh, duke bashkuar akademinë dhe institucionet publike për të promovuar rolin strategjik të gjeoinformacionit në Shqipëri. Dita e parë, më **18 nëntor 2025**, u organizua në ambientet e **Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT)**, ku fillimisht u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ASIG–UPT dhe më pas u mbajt tryeza e rrumbullakët “Sfidat e gjeoinformacionit në Shqipëri në kuadër të GIS Day”, gjatë së cilës u theksua rëndësia e të dhënave gjeohapësinore në planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ditën pasuese, më **19 nëntor 2025**, programi vijoi në ambientet e Piramidës së Tiranës, në bashkëpunim me **Universitetin POLIS**, përmes prezantimeve dhe sesioneve interaktive me studentët mbi përdorimet praktike të GIS dhe teknologjive satelitore në monitorimin e territorit dhe planifikimin urban, ku u nënshkrua edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit ASIG–Universiteti POLIS, duke forcuar më tej rolin e ASIG si pikë referimi dhe partner i qëndrueshëm i universiteteve në fushën e gjeoinformacionit. GIS Day 2025 ishte një hap konkret drejt konsolidimit të një ekosistemi modern gjeoinformacioni, në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe vendimmarrjes së bazuar në evidenca, si dhe pikënisje për nisma që në të ardhmen do të çojnë në ngritjen e platformave dhe forumeve të strukturuar të bashkëpunimit.



Fotografimi Ajror me teknologjinë UAV

ASIG ka realizuar rilevimin fotogrametrik të zonës urbane të qytetit të Korçës me teknologjinë UAV, duke mbuluar një sipërfaqe prej 16.2 km² me rezolucion hapësinor 4 cm. Kombinimi i fotografimit vertikal me metodën oblique ka mundësuar marrjen e imazheve nga kënde të ndryshme, gjë e cila rrit saktësinë e modelimit të mjedisit urban dhe ofron bazë të detajuar për analiza gjeohapësinore dhe planifikim territorial. Në kuadër të këtij procesi, janë prodhuar produkte gjeohapësinore me saktësi të lartë, si: Ortofoto (rezolucion deri në 3 cm), Modeli Digjital i Sipërfaqes (Digital Surface Model – DSM), Modeli Digjital i Terrenit (Digital Terrain Model – DTM) dhe izoipse me shpeshësi çdo 1 m.

Këto produkte krijojnë një infrastrukturë të besueshme referimi për projektet zhvillimore në nivel lokal dhe kombëtar.



Ortofoto UAV, Korçë





Izoipse, Korçë

Përditësim të Dhënash Gjeohapësinore në Gjeoportalin Kombëtar

ASIG në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) ka përditësuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor për temën "Hidrografia", mbi lejet e dhëna për përdorimin e burimeve ujore nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU) dhe Këshillat e Baseneve Lumore (KBL) për shtresat:

- Veprimtari ndërtimore në brigje;
- Shfytëzimin e materialeve inerte në brigjet e lumenjve / përrenjve;
- Qëllime kurative dhe termale;
- Akuakulturë;
- Ujitje në bujqësi;
- Industri dhe teknologji;
- Hidroenergji, HEC-et;
- Përdorime të tjera të ujit: sanitar, lavazh, familjar sanitar, pishina;
- Inbotilim.


Të dhënat e përditësuara janë konform standardit shtetëror për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri.



Zgjerimi i Hartës Bazë

Zona Ças - Luarzë në Shkodër

ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën “Harta Bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për zonën rurale Ças-Luarzë në Bashkinë Shkodër. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rlevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rlevuar prej 21 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rlevime fotogrametrike 3D arrin në 180.



PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ASIG – AAC



Më 17 nëntor 2025, ASIG dhe Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi, e cila konsolidon bashkëpunimin institucional dhe synon përmirësimin e proceseve të sigurisë ajrore në zonat e mbrojtura aeroportuale. Kjo marrëveshje i siguron AAC akses në të dhëna statike dhe dinamike të terrenit për përpunim, analizë dhe vizualizim të saktë të rreziqeve potenciale rreth aeroporteve, si dhe parashikon trajtimin me prioritet të lejeve për operime me avionë pa pilot, në përputhje me standardet e sigurisë. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, shfrytëzimi i informacionit gjeohapësinor kthehet në një instrument konkret mbështetjeje për planifikimin dhe menaxhimin e sigurisë në hapësirën ajrore. Palët angazhohen gjithashtu në zhvillimin e takimeve periodike për të koordinuar bashkëveprimet, për të shkëmbyer eksperiencë teknike dhe për të garantuar integritetin dhe cilësinë e të dhënave të përdorura në fushën e aviacionit civil.

Vizitë studimore e studentëve të Universitetit “Hasan Prishtina” në ASIG

ASIG mirëpriti më 7 nëntor 2025 një grup studentësh Master nga Universiteti “Hasan Prishtina” i Republikës së Kosovës, profili “Planifikim i qëndrueshëm urban dhe regjional”, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes dy institucioneve. Vizita kishte për qëllim thellimin e njohurive të studentëve mbi rolin dhe funksionimin e sistemeve GIS në proceset e planifikimit, bazuar në praktikën e ASIG. Ekspertët e ASIG prezantuan veprimtarinë e institucionit, funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar si dhe shembuj konkretë të ciklit të punës nga mbledhja e të dhënave në terren deri te përpunimi në software GIS. Vizita ofroi një përvojë mësimore dhe praktike, duke i ndihmuar studentët të kuptojnë se si informacioni gjeohapësinor kthehet në vendimmarrje dhe në zhvillime urbane të mirëplanifikuara.



TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me ASPA, ASIG ka realizuar për herë të parë hartimin e kurrikulave të specializuara për rritjen e kapaciteteve të stafëve teknike në fushën e gjeoinformacionit për administratën publike. Në vijim të bashkëpunimit dhe në përputhje me këto kurrikula, gjatë muajit nëntor u zhvilluan trajnime mbi temat:

- Hyrje në Remote Sensing — 05.11.2025 (21 pjesëmarrës);
- Aplikimet e Imazherisë Satelitore për përmirësimin e të Dhënave Gjeohapësinore — 13.11.2025 (20 pjesëmarrës);
- Infrastruktura Kombëtare e Ofrimit të të Dhënave dhe Shërbimeve Gjeohapësinore — 20.11.2025 (17 pjesëmarrës).

Këto aktivitete përbëjnë një hap të rëndësishëm në rritjen e profesionalizmit të stafëve teknike dhe përdorimit të teknologjive gjeohapësinore në planifikim, menaxhim territori dhe shërbime publike. Pjesëmarrësit në këto trajnime do të pajisen me certifikatë nga ASPA.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Copernicus Sentinel-1D nis misionin e ri të vëzhgimit të Tokës

Më 4 nëntor 2025, u lëshua në orbitë sateliti Copernicus Sentinel-1D nga Guajana Franceze, duke garantuar vazhdimësinë e sistemit më të avancuar radarik të vëzhgimit të Tokës. Sateliti do të sigurojë imazhe me rezolucion të lartë, si ditën ashtu edhe natën, në çdo kusht moti, në mbështetje të monitorimit mjedisor, survejimit detar dhe reagimit ndaj emergjencave, përfshirë zbulimin e derdhjeve të naftës, përmbytjeve, rrëshqitjeve të dheut dhe aktiviteteve të paligjshme në det. Të dhënat e Sentinel-1D, të cilat do të jenë të hapura për përdoruesit publikë dhe privatë, do të forcojnë më tej rolin e programeve Copernicus dhe EU Space Programme në mbrojtjen e mjedisit, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Evropë dhe më gjerë.

Rritet disponueshmëria e të dhënave gjeohapësinore zyrtare në platformën CORDA

Përmes bashkëpunimit të EuroGeographics dhe autoriteteve kombëtare hartografike, kadastrale dhe të regjistrimit të pasurive, numri i seteve të të dhënave gjeohapësinore nëpërmjet platformës CORDA është rritur me 117 të reja dhe 42 të përditësuara. Aktualisht, 33 autoritete kombëtare ofrojnë të dhëna për Shërbimin e Hartëzimit të Emergjencave Copernicus (Copernicus Emergency Mapping Service – CEMS), Shërbimin e Monitorimit të Tokës Copernicus (Copernicus Land Monitoring Service – CLMS) dhe Shërbimin e Sigurisë Copernicus (Copernicus Security Service – CSS), duke mbështetur reagimin ndaj fatkeqësive, monitorimin e tokës dhe sigurinë. Kjo marrëveshje, në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Mjedisit (European Environment Agency – EEA), ul barrierat ligjore dhe nxit përdorimin e të dhënave gjeohapësinore zyrtare në nivel kombëtar dhe evropian.

AKTIVITETE NË VIJIM

SATELLITE SUMMIT 2025

Më 17–18 dhjetor 2025, në Amsterdam, të Hollandës, do të zhvillohet Samiti i 7 për Teknologjinë e Komunikimeve Satelitore dhe Hapësinore. Ky aktivitet ndërkombëtar do të shërbejë si forum kryesor për të eksploruar zhvillimet më të fundit dhe teknologjitë transformuese në sistemet satelitore, rrjetet hapësinore dhe ndërlidhjen globale, duke përfshirë dizajnin e satelitëve, integrimin 5G/6G, vëzhgimin e Tokës.

17-18 Dhjetor 2025

www.asig.gov.al

ICGISA - 26

Më 10–11 janar 2026, në Lisbonë të Portugalisë, do të zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare mbi Inteligjencën Gjeohapësinore dhe Aplikimet për Sigurinë. Aktiviteti synon të trajtojë zhvillimet në inteligjencën gjeohapësinore dhe përdorimet e saj për sigurinë, duke nxitur shkëmbimin shkencor, bashkëpunimin ndërmjet studiuesve dhe institucioneve të angazhuara në analizën e të dhënave gjeohapësinore.

10 - 11 Janar 2026

Telefon: +355 (0)42 223 762;

ICBDIG - 26

Nga data 10–11 shkurt 2026, në Berlin të Gjermanisë, do të zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare mbi Integrimin e Big Data me GIS (ICBDIG), një aktivitet i fokusuar në integrimin e të dhënave të mëdha me GIS. Konferenca përfshin sesione teknike dhe diskutime mbi analiza hapësinore, vizualizimin dhe menaxhimin e të dhënave, duke mbështetur zhvillimin e aplikimeve praktike dhe innovative në këtë fushë.

10 - 11 Shkurt 2026

www.geoportal.asig.gov.al

E-mail: info@asig.gov.al